



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 janar 2020
Nr. ref.:RK 1507/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI90/18

Parashtrues

Nedvedete Ponosheci dhe Atdhe Ponosheci

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 89/2018, të 8 majit 2018, në ndërlidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 397/17, të 19 gushtit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR. nr. 61/14, të 21 qershorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nedvedete Ponosheci dhe Atdhe Ponosheci me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [Pml. nr. 89/2018] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 8 majit 2018, në ndërlidhje me Aktvendimin [PAKR. nr. 397/17] e Gjykatës së Apelit, të 19 shtatorit 2017 dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 61/2014] e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 21 qershorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, të cilat pretendohet t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së si dhe nenet 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] e 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
4. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 korrik 2018, parashtruesit e kërkesës e dërguan kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu- Krasniqi.
8. Më 3 shtator 2018, Gjykata i informoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata, plotësimin e formularit. Gjykata Supreme u njoftua gjithashtu për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 17 shtator 2018, parashtruesit e kërkesës e sollën formularin e kërkesës të kërkuar nga Gjykata. Në formular kishin shënuar se i përfaqëson avokati Teki

Bokshi, por nuk e kishin dorëzuar autorizimin përkatës. Si rrjedhojë, Gjykata kërkoi nga parashtruesit e kërkesës bashkëngjitjen e autorizimit.

10. Më 26 shtator 2018, parashtruesit e kërkesës bashkëngjitën autorizimin dhe gjithashtu bashkëngjitën një shkresë shtesë me citime të rasteve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ).
11. Më 22 tetor 2018, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Gjakovë dorëzimin e dosjes së lëndës.
12. Më 14 nëntor 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë, dërgoi dosjen e lëndës siç u kërkua nga Gjykata më 22 tetor 2018.
13. Më 15 janar 2020, Kolegj shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Faktet rreth vdekjes së personit F. P.

14. Më 9 qershor 2013, F. P. - bashkëshorti i Nedvedete Ponoshecit dhe babai i Atdhe Ponoshecit (parashtruesve të kërkesës) u sulmua fizikisht nga dy persona, përkatësisht F. GJ. dhe B. N., në një lokal në Gjakovë në të cilin F. P. kishte punuar.
15. Më 28 qershor 2013, nga lëndimet e marra F. P. kishte ndërruar jetë.
16. Në bazë të shkresave të lëndës, personi B. N. rezulton të jetë i arratisur.

Ngritja e aktakuzës, procedurat për marrëveshjen për pranimin e fajësisë të personit F. GJ.

17. Më 24 mars 2014, Prokuroria Themelore në Gjakovë, ngriti aktakuzën [PP/I. nr. 237/2013] kundër të akuzuarve B. N. dhe F. GJ. për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329, paragrafi 5 lidhur me paragrafët 3 dhe 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
18. Më 3 maj 2016, Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda, përkatësisht Prokurori i Shtetit (në tekstin e mëtejme: prokurori i rastit), lidhi marrëveshjen për pranimin e fajësisë me personin F. GJ. për veprën penale të bashkëkryerjes në grabitje nga neni 329, paragrafi 5 lidhur me paragrafët 3 dhe 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Prokurori i Shtetit pas negocimit të marrëveshjes me avokatin mbrojtës të F. GJ. kishte arritur pajtim për ricilësimin e veprës penale ku tani F. GJ. ngarkohej me kryerjen e veprës penale të ndihmës në grabitje nga neni 329, paragrafi 5 lidhur me paragrafët 3 dhe 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së. Për këtë, palët në këtë procedurë (Prokurori i Shtetit, F.

GJ. dhe avokati i tij) ranë dakord që F. GJ., t'i shqiptohet dënimi me burgim efektiv prej 5 vjet deri në 5 vjet e 6 muaj.

19. Marrëveshja për pranimin e fajësisë e 3 majit 2016, iu dorëzua Gjykatës Themelore në Gjakovë, në mënyrë që të merr vendim për pranimin apo refuzimin e kësaj marrëveshje bazuar në dispozitat e nenit 233, paragrafi 18 nënparagrafi 1,2,3 dhe 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK).
20. Më 19 maj 2016, parashtruesit e kërkesës, parashtrojnë një kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, duke kërkuar (i) shtyrjen e gjykimit; (ii) dorëzimin e aktakuzës sepse atyre nuk iu ishte dorëzuar ajo; si dhe (iii) të marrin pjesë në negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.
21. Më 7 qershor 2016, parashtruesit e kërkesës dorëzojnë një parashtrësë/shkresë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, me anë të cilës deklarojnë se kanë pranuar aktakuzën PP/I. nr. 237/2013, të 24 marsit 2014 dhe kërkojnë nga F. GJ. shumën prej 100.000 € në emër të kompensimit, si dhe kërkojnë t'i shqiptohet personit F. GJ. dënim sa më i rëndë.
22. Më 10 qershor 2016, prokurori i rastit pranë Prokurorisë Themelore, përpilon procesverbal mbi marrjen e deklaratës së të dëmtuarit në procedurë paraprake, në të cilën parashtruesit e kërkesës (i) deklarohen se kundërshtojnë marrëveshjen për pranimin e fajësisë sepse konsiderojnë se sanksioni i negociuar është shumë i ulët, dhe (ii) njëkohësisht parashtrojnë kërkesën pasurore-juridike. Si rrjedhojë, prokurori i rastit me anë të një shkrese, në po të njëjtën ditë, njofton kryetarin e trupit gjykues ta refuzojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë të 3 majit 2016, për shkak se prokurori i rastit është tërhequr nga marrëveshja.
23. Më 9 qershor 2017, Prokuroria Themelore dhe palët në procedurë arritën marrëveshje për pranimin e fajësisë. Në këtë marrëveshje prokurori i rastit bëri ricilësimin e veprës penale nga vepra penale bashkëkryerjes në grabitje sipas nenit 329, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në veprën penale të ndihmës në grabitje nga neni 329, paragrafi 5 lidhur me paragrafët 3 dhe 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës në këtë marrëveshje kishte deklaruar se e kundërshton atë sepse (i) lartësia e dënit është e ulët dhe joproportionale me veprimet e F. GJ., dhe (ii) kërkoi të merret parasysh çështja e pazgjidhur pasurore-juridike, përkatësisht kompensimi i dëmit prej 100 mijë €.

Vendimet e gjykatave të rregullta

24. Më 21 qershor 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), mbajti seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku të ftuar ishin dhe parashtruesit e kërkesës të cilët kërkuan kompensim dëmi prej 100 mijë €. Në procesverbalin e seancës, kryetari i trupit gjykues merr aktvendim në të cilin theksohet se prokurori i rastit në marrëveshjen për pranimin e fajësisë bën edhe

ricilësimin juridik të veprës penale nga vepra penale: *“Grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329, par. 3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPPK-së, në veprën penale: Të ndihmës në Grabitje nga neni 329 paragrafët 5, 3 lidhur me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 33 të KPPK-së”*.

25. Në po të njëjtën ditë, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin PKR. nr. 61/14 dhe vendosi lidhur me propozimin për pranimin e fajësisë sipas propozimit të Prokurorisë Themelore të 9 qershorit 2017. Gjykata Themelore shpalli fajtor personin F. GJ. për kryerjen e veprës penale të ndihmës në grabitje sipas nenit 329, paragrafi 5 lidhur me paragrafët 3 dhe 1 lidhur me nenin 33 të KPPK-së. Gjykata Themelore arsyetoi se gjendja faktike është vërtetuar jo vetëm nga pranimi i fajësisë nga ana e F. GJ., por edhe provat e administruara.
26. Si rrjedhojë, për kryerjen e veprës penale, personi F. GJ. u dënua me burgim me kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtruesit e kërkesës u udhëzuan që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në kontest civil siç parashihet me nenin 463, paragrafi 2 të KPPRK-së.
27. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke theksuar se *“Marrëveshja është arritur për kompensimin e shumës prej 100.000 €”*. Sipas parashtruesve të kërkesës Gjykata Themelore do të duhej të kishte përcaktuar në Aktgjykim që *“i akuzuari të detyrohet që t’ia paguajë kompensimin e dëmit në shumën prej 100.000 €”*. Andaj, parashtruesit e kërkesës pretenduan që Gjykata Themelore nuk do të duhej t’i kishte udhëzuar ata në kontest civil, sepse sipas tyre shuma e kërkuar ishte e pakontestueshme. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu nuk u pajtuan me sanksionin penal.
28. Më 19 gusht 2017, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktvendimit PAKR. nr. 397/17, hodhi poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesve të kërkesës. Gjykata e Apelit, fillimisht theksoi se marrëveshja për pranimin e fajësisë është arritur me 9 qershor 2017 në prezencën e prokurorit të rastit, personit F. GJ. dhe mbrojtësit të tij, si dhe në prani të përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, ndërsa theksoi se edhe në shqyrtimin gjyqësor të 21 korrikut 2017, marrëveshja e pranimit të fajësisë është pranuar nga kryetari i trupit gjykues në praninë e të gjitha palëve. Gjykata e Apelit tutje arsyetoi se *“[...] në kuptim të nenit 381 paragrafi 3 të KPPK-së, i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale, kurse sa i përket kompensimit të dëmit, gjykata e shkallës së parë, palën e dëmtuar e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, e cila është përfshirë edhe në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë”*.
29. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën tek Prokurori i Shtetit një propozim për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta. Si rrjedhojë, më 10 nëntor 2017, Prokurori i Shtetit, parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për

shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale me arsyetimin se marrëveshja për pranimin e fajësisë nuk është zbatuar sa i përket kompensimit të dëmit, dhe konsiderojnë që në bazë të nenit 233, paragrafi 12, nënparagrafi 12.4 të KPPRK-së gjykatat kanë qenë të obliguara të vendosin dhe për kërkesën pasurore-juridike të palës. Sa i përket hedhjes poshtë të ankesës së parashtruesve të kërkesës, Prokuroria e Shtetit theksoi se vepra penale e grabitjes ka rezultuar në vdekjen e të ndjerit F. P., andaj Gjykata e Apelit, do duhej të kishte vendosur në procedurën penale edhe për kompensimin.

30. Më 8 maj 2018, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 89/2018], refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit. Gjykata Supreme arsyetoi se:

“[...] qëndron fakti se në të njëjtën seancë dëgjimore përfaqësuesi i [parashtruesve të kërkesës] ka paraqitur kërkesën për kompensim dëmi në shumë prej 100.000 € dhe se njëkohësisht ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se përfaqësuesja ligjore e palës së dëmtuar Nevedete Ponosheci ka deklaruar se pajtohet me kërkesën e paraqitur nga përfaqësuesi i saj i autorizuar. Po ashtu qëndron fakti se i dënuari F. GJ para seancës në Prokurorinë Themelore në Gjakovë [...] ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe se në atë rast përfaqësuesi i [parashtruesve të kërkesës] ka parashtruar kërkesën pasurore-juridike në shumën prej 100.000 € dhe se mbrojtësi i [F. GJ.] ka deklaruar se nuk e kundërshton kërkesën për kompensim dëmi”.

31. Gjykata Supreme lidhur me pretendimin dhe referimin tek neni 233, paragrafi 12 pika 12.4 të KPPRK-së theksoi se kemi të bëjmë me “përgjegjësinë e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimin e të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit nga kapitulli XVIII të [KPPRK-së] dhe është një prej kushteve minimale të cilat duhet t’i përmbajë marrëveshja për pranimin e fajësisë. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesën pasurore-juridike dhe jo me konfiskim të pasurisë dhe rregullat të cilave i nënshtrohet konfiskimi dhe të cilat shërbenin për kompensimin e të dëmtuarit gjë që pretendimin e Prokurorit të Shtetit e bënë të paqëndrueshëm. Po ashtu konform dispozitës së nenit 233, paragrafi 13 të KPPK-së, të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin ka ajo palë, kur konstatohet se gjykata shqipton dënim jashtë kufijve të dakorduar sipas marrëveshjes në dëm të ndonjëres prej palëve, e në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të dakorduar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, andaj me të drejtë Gjykata e Apelit e ka hedhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit të autorizuar dhe përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar”.
32. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për kërkesën e tyre për kompensim dëmi në shumën prej 100.000 €, Gjykata Supreme e konsideroi si të paqëndrueshme sepse në rastin konkret “gjykata e shkallës së parë ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në të cilën asnjëherë nuk është cekur se i dënuari duhet të kompensojë shumën e caktuar – kërkesën pronëso-ro-juridike të palës së dëmtuar, edhe pse avokati mbrojtës ka potencuar se nuk kundërshton kërkesën pronëso-ro-juridike, gjë që nuk do të

thotë se është pajtuar ta kompensojë këtë kërkesë, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pronësore-juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë që me vendimet e kontestuara u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtarë], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) KEDNJ-së, si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
34. Parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se janë të pakënaqur me veprimet e ndërmarra nga organet e prokurorisë dhe organet gjyqësore dhe pohojnë se *“shkeljet janë bërë në prokurorinë themelore dhe në gjykatat e të gjitha niveleve”*.
35. Lidhur me pretendimin e mësipërm, parashtruesit e kërkesës theksojnë se u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për arsye se sipas tyre, marrëveshja për pranimin e fajësisë paraqet shkelje të rëndë dhe kontestojnë ricilësimin e veprës penale nga ana e prokurorit të rastit sepse sipas pretendimit kjo nuk parashihet me dispozitat ligjore dhe me këtë personi F. GJ. *“është privilegjuar pa bazë”*. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se marrëveshja për pranimin e fajësisë sa i përket sanksionit penal është në kundërshtim me nenin 233, paragrafi 7.1 dhe 7.2 të KPPRK-së.
36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u është shkelur dhe *“parimi i qasjes në drejtësi”* sepse Gjykata e Apelit *“gabimisht ka hedhë poshtë ankesën si të palejuar”* për çka atyre iu është mohuar e drejta e qasjes në drejtësi. Sipas parashtruesve të kërkesës, Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë ankesën pa arsye të qarta se pse është e palejuar dhe pohojnë që *“si duket vrasja e anëtarit të familjes së të dëmtuarve, Gjykatës së Apelit nuk iu ka dukur si vepër penale kundër jetës dhe trupit”*.
37. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është shkelur dhe *“parimi i barazisë së armëve”* sepse personi F. GJ. ka përfituar vetëm benefitet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ndërsa obligimet e asaj marrëveshje, përkatësisht kërkesa për kompensim dëmi, nuk është shqiptuar.
38. Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ka qenë jokontestuese shuma prej 100.000 € dhe taksativisht qëndron në marrëveshjen e pranimin të fajësisë të 9 qershorit 2017 që *“[...] si palë e akuzuar ne nuk kundërshtojmë atë kërkesë për kompensim dëmi”*. Andaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që mohimi i kërkesës pronësoro-juridike paraqet shkelje të së drejtës në pronësi.

39. Parashtruesit e kërkesës duke iu referuar disa aktgjykimeve të GJEDNJ-së që kanë trajtuar çështjen e vendimit të arsyetuar, theksojnë se në vendimet e kontestuara nuk janë dhënë arsytet e duhura dhe potencojnë rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* dhe duke cituar paragrafin 26 të këtij vendimi i cili thotë “**në hedhjen poshtë të një ankese, një Gjykatë Apeli mundet së pari, thjeshtë të miratojë arsytet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës të shkallës më të ulët**”.
40. Si përfundim, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: “[...] t’i anulojë dhe t’i shpallë kundërkushtetuese vendimet gjyqësore”.

Dispozitat përkatëse ligjore

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

(i) Sa i përket marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

Neni 233

[Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë]

1. Në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës, Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri dhe Prokurori i Shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për:

1.1. pajtimin e Prokurorit të Shtetit që t’i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e paraparë me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin 7 të këtij neni; ose

1.2. konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi.

2. Në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri pranon fajësinë në shkëmbim për:

2.1. pajtimin e Prokurorit të Shtetit që t’i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e parashikuar me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin 7 të këtij neni; ose

2.2. konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi.

3. Në rastet kur i pandehuri dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, mbrojtësi i të pandehurit, ose i pandehuri nëse nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, kërkon nga Prokurori i Shtetit një takim paraprak për të filluar negociimin për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Në të gjitha negociatat e tilla, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

4. Pas pranimit të kërkesës për takim paraprak, Prokurori i Shtetit informon kryeprokurorin e zyrës së tij përkatëse, i cili jep autorizim me shkrim për mbajtjen e takimit për diskutimet mbi pranimin e fajësisë, në të

cilin deklaratave të të pandehurit do t'i jepet imunitet i kufizuar, siç parashihet me paragrafin 11 të këtij neni. Të gjitha marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë duhet të jenë në formë të shkruar dhe të pranuar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë para se formalisht t'i ofrohen të pandehurit.

5. Në rastet kur Prokurori i Shtetit dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit merr miratimin e kryeprokurorit të zyrës së tij përkatëse për të filluar negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Pas miratimit nga kryeprokurori i zyrës së tij përkatëse, prokurori i shtetit:

5.1. i dërgon letër mbrojtësit të të pandehurit në të cilën përshkruhet marrëveshja e ofruar, përfshirë kushtet e përcaktuara në paragrafin 12 të këtij neni; ose

5.2. takohet me mbrojtësin dhe të pandehurin për të negociuar mundësinë dhe kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Paragrafi 4 i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht.

6. Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë mund të përfshijë dispozitën që Prokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 236 të këtij Kodi, do të kërkojë nga gjykata dhënien e urdhrit që të shpall të pandehurin si "dëshmitar bashkëpunues", siç përkufizohet në nenin 235 të këtij Kodi. Nëse i pandehuri i ndihmon si dëshmitar bashkëpunues, Prokurori i Shtetit do t'i rekomandojë gjykatës një dënim më të butë në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni që reflekton nivelin e ndihmës dhe bashkëpunimit të dhënë nga i pandehuri, duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale.

7. Në pajtim me marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë, Prokurori i Shtetit mund të rekomandojë dënim më të butë nga paragrafi 1 nënparagrafi 1.1., paragrafi 2 nënparagrafi 2. 1. dhe paragrafi 6 të këtij neni por vetëm deri në atë shkallë që lejohet sipas formulimit të mëposhtëm: [...]

8. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij duhet të jenë të pranishëm gjatë takimeve mbi negocimin e pranimit të fajësisë dhe duhet të pajtohen me kushtet e marrëveshjes me shkrim mbi pranimin e fajësisë para se ajo t'i paraqitet gjykatës. Kur i pandehuri nuk merr pjesë si dëshmitarë bashkëpunues, zbatohen kushtet e mëposhtme. Prokurori i Shtetit informon të dëmtuarin për marrëveshjen e arritur, pasi që marrëveshja të jetë në formën përfundimtare. Kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike që rrjedh nga vepra penale e cekur në aktakuzë, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet ta adresojë kërkesën e të dëmtuarit dhe Prokurori i Shtetit duhet të njoftojë të dëmtuarin se i pandehuri kërkon të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Të dëmtuarit duhet t'i jepet rasti që t'i paraqesë deklaratë gjykatës mbi kërkesën e tillë pasurore-juridike para se gjykata ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

9. Kur i pandehuri merr pjesë si dëshmitar bashkëpunues, Prokurori i Shtetit siguron që kërkesa pasurore-juridike e të dëmtuarit të trajtohet me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike që rrjedh nga vepra penale e cekur në aktakuzë, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet ta trajtojë kërkesën e të dëmtuarit. Të dëmtuarit duhet t'i jepet rasti që t'i paraqesë deklaratë

gjykatës mbi kërkesën e tillë pasurore-juridike para se gjykata t'i shqiptojë dënimin të pandehurit sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

10. Gjykata nuk merr pjesë në negocimin e pranimin të fajësisë, por mund të caktoj afat të arsyeshëm kohor, jo më të gjatë se tre (3) muaj, për përfundimin e negociatave në mënyrë që të pengohen zvarritja e procedurës.

11. Në çdo kohë para se gjykata të pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, Prokurori i Shtetit ose i pandehuri mund të refuzojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues do të caktoj shqyrtimin gjyqësor siç parashihet me Kapitullin XIX të këtij Kodi. Në qoftë se Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi apo i pandehuri nuk arrijnë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ose nëse marrëveshja nuk pranohet nga gjykata, deklaratat e të pandehurit të dhëna gjatë negocimit të pranimin të fajësisë, siç parashihet në paragrafët 3, 4 dhe 5 të këtij neni janë provë e papranueshme në shqyrtim gjyqësor ose në procedurë tjetër të ndërlydhur.

12. Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse, mbrojtësi dhe i pandehuri, dhe është detyruese për të gjitha palët nënshkruese. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet së paku të përfshijë:

12.1. pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri pranon fajësinë;

12.2. nëse i pandehuri pranon të bashkëpunojë;

12.3. të drejtat nga të cilat hiqet dorë;

12.4. përgjegjësia e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimi i të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit nga Kapitulli XVIII i këtij Kodi.

13. Marrëveshja po ashtu mund të përfshijë dispozitën ku palët pajtohen për kufijtë e dënimin që do të propozohet nga ana e Prokurorit të Shtetit nëse i pandehuri bashkëpunon substancialisht, ndërsa nëse gjykata shqipton dënim jashtë këtyre kufijve në dëm të ndonjëres prej palëve, ajo palë ka të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin.

[...]

18. Gjatë shqyrtimit se a duhet pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata duhet të dëgjoj të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe Prokurorin e Shtetit dhe të përcaktojë nëse:

18.1. i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë;

18.2. pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, nëse ka mbrojtës, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë;

18.3. pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera, siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri; dhe

18.4. nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253, paragrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi.

19. Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata duhet të dëgjojë pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit. Nëse marrëveshja e të pandehurit për bashkëpunim dhe pranim të fajësisë është e mbyllur në pajtim me paragrafin 17 të këtij neni, gjykata i lejon të dëmtuarit të jep deklaratë në përfundim të bashkëpunimit të të pandehurit, para shqiptimit të dënimit.

20. Nëse gjykata nuk bindet se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18 të këtij neni, gjykata refuzon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe rasti vazhdon në gjykim të rregullt ashtu siç parashihet me këtë Kod.

[...]

(ii) Sa i përket kërkesës pasurore-juridike

Neni 459

[Personat e autorizuar për paraqitjen e propozimit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike]

1. Propozimin për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në procedurë penale mund ta paraqesë personi i cili është i autorizuar për ta ushtruar këtë kërkesë në kontest civil. [...]

Neni 460

[Paraqitja e propozimit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike]

1. Propozimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në procedurë penale i paraqitet organit kompetent të cilit i është parashtruar kallëzimi penal ose gjykatës para së cilës zbatohet procedura.

2. Propozimi mund të paraqitet jo më vonë se deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën themelore.

3. Personi i autorizuar për paraqitjen e propozimit detyrohet ta parashtrojë në mënyrë të qartë kërkesën e vet dhe të paraqesë prova.[...]

Neni 463

[Vendimi mbi propozimin për realizimin e kërkesës pasurore-juridike]

1. Për kërkesat pasurore-juridike vendos gjykata.

2. Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore-juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore-juridike mund ta realizojë në kontest civil.

3. Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore-juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente.

Neni 466

[Ndryshimi i aktgjykimit të formës së prerë lidhur me kërkesën pasurore-juridike]

1. Gjykata që zbaton procedurën penale, mund ta ndryshojë aktgjykimin e formës së prerë me të cilin është vendosur për kërkesën pasurore-juridike vetëm në rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.[...]

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
[...].”*

42. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtguesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtguesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtguesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

43. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

*(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,
[...]*

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;”

44. Para vlerësimit të kriterëve të lartpërmendura të pranueshmërisë, Gjykata fillimisht rikujton se si pasojë e kryerjes së veprës penale, bashkëshorti i Nedvedete Ponosheci dhe babai i Atdhe Ponosheci kishte vdekur. Më 9 qershor 2017, u arrit marrëveshje për pranimin e fajësisë, në praninë e palëve, përkatësisht të akuzuarit F. GJ., avokatit të akuzuarit dhe familjes së të ndjerit F. P. (parashtguesve të kërkesës). Rrjedhimisht, më 21 qershor 2017, Gjykata Themelore me Aktgjykimin PKR. nr. 61/14 vendosi lidhur me propozimin për pranimin e fajësisë sipas propozimit të Prokurorisë Themelore, të 9 qershorit 2017 dhe shpalli fajtor personin F. GJ. për kryerjen e veprës penale të ndihmës në grabitje, për të cilën F. GJ. u dënua me burgim përkatës, ndërsa parashtguesit e kërkesës u udhëzuan që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në kontest civil siç parashihet me KPPRK.

45. Parashtguesit e kërkesës parashtuan ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kjo e fundit hodhi poshtë si të palejuar ankesën e parashtguesve të kërkesës, duke arsyetuar se i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj Aktgjykimit vetëm lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale, kurse sa i përket kompensimit të dëmit, gjykata e shkallës së parë, palën e dëmtuar e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, e cila është përfshirë edhe në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Prokuroria e Shtetit, parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale me arsyetimin se marrëveshja për pranimin e fajësisë nuk është zbatuar sa i përket kompensimit të dëmit, dhe që në bazë të dispozitave të KPPRK-së gjykatat kanë qenë të obliguara të vendosin edhe për kërkesën pasurore-juridike të palës. Rrjedhimisht, me Aktgjykimin [Pml. nr. 89/2018] e 2 majit 2018, Gjykata

Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit dhe arsyetoi në thelb se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka udhëzuar në kontest të rregullt civil palën e dëmtuar (parashtruesit e kërkesës) për realizimin e kërkesës pronësore-juridike.

46. Në procedurat pranë gjykatave të rregullta, parashtruesit e kërkesës në mënyrë të përsëritur pretendojnë se (i) sanksioni penal i shqiptuar ndaj personit F. GJ. nuk është proporcional; (ii) marrëveshja për pranimin e fajësisë është joligjore; dhe se ata (iii) nuk janë kompensuar sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë.
47. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, në procedurat pranë gjykatave të rregullta dhe në pajtim me dispozitat e KPPRK-së, konsiderohen palë e dëmtuar. Në pretendimet e tyre pranë Gjykatës, parashtruesit e kërkesës kanë ngritur shkeljen e të drejtave kushtetuese në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe përsërisin pretendimet e tyre, siç i kanë parashtruar dhe pranë gjykatave të rregullta.
48. Siç u përmend dhe më lart, parashtruesit e kërkesës në procedurat pranë gjykatave të rregullta janë paraqitur në cilësinë e palës së dëmtuar. Legjislacioni penal në Republikën e Kosovës njeh statusin e të dëmtuarve dhe viktimës në procedurë penale. Gjykata vëren se sipas përkufizimeve të përcaktuara në nenin 19 të KPPRK-së, i dëmtuar ose viktimë është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale. Të drejtat e të dëmtuarit sipas KPPRK-së *inter alia* konsistojnë në kompensimin e arsyeshem të urdhëruar nga gjykata prej të pandehurit ose të pandehurve që kanë pranuar ose janë shpallur fajtor për dëmin material, fizik dhe emocional të shkaktuar nga kryerja e veprës penale për të cilën i pandehuri ose të pandehurit janë shpallur fajtorë. Sipas po të njëjtit nen, i dëmtuari ka cilësinë e palës në procedurë penale. Për më tepër, sipas paragrafit 18 të nenit 233 të KPPRK-së, gjykata duhet të dëgjojë pikëpamjet e të pandehurit, mbrojtësit të tij dhe Prokurorit të Shtetit, me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.
49. Gjykata, duke iu adresuar pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, së pari duhet të shqyrtojë se në çfarë rrethanash mund të përfitojnë viktimat përkatësisht të dëmtuarit në procedurë penale, në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe nga cilat garancione mund të përfitojnë ata, përkatësisht çështjet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës a janë *ratione materiae* në pajtueshmëri me Kushtetutën.
50. Gjykata fillimisht thekson se bazuar në KEDNJ, nuk ka dispozita të veçanta me të cilat adresohen të drejtat e viktimave në procedurë penale. Megjithatë, çështja e viktimave është trajtuar në disa raste të GJEDNJ-së, dhe kjo sa i përket të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Një gjë të tillë, GJEDNJ e ka theksuar dhe në rastin *Perez kundër Francës*, rast ky i cili ka ndërmarrë një qasje të re sa i përket viktimave, por në fushën civile. Në këtë rast, GJEDNJ theksoi:

"[...] vetëm për shkak se kërkesat e pandashme të konceptit "gjykim i drejtë" nuk janë domosdoshmërisht të njëjta në kontestet për të drejtat dhe

detyrimet civile siç janë në rastet që përfshijnë gjykimet penale, gjë që dëshmohej me faktin se, për kontestet civile nuk ka dispozita të hollësishme sikurse ato që janë në nenin 6, paragrafët 2 dhe 3 ... nuk do të thotë që Gjykata mund të injorohet gjendjen e rëndë të viktimave dhe të minimizojë të drejtat e tyre"(shih Perez kundër Francës [DHM], nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 72).

51. Për t'i adresuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës rreth (i) ricilësimit të veprës penale gjatë negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të shqiptuar ndaj personit F. GJ. si dhe (ii) kompensimit të shumës së kërkuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, Gjykata së pari do të trajtojë se si aplikohet neni 6 i KEDNJ-së në aspektin penal dhe aspektin civil dhe do të trajtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në aspektin penal

52. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.
53. Si çështje themelore në këtë kërkesë dhe në të gjitha kërkesat që dorëzohen në këtë Gjykatë, së pari duhet të vërtetohet nëse të drejtat e pretenduara nga parashtruesit janë në pajtim me juridiksionin material (*ratione materiae*) të Gjykatës. Pra, duhet vërtetuar nëse të drejtat e pretenduara janë të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih në këtë kontekst rastin e Gjykatës, KI174/18, parashtrues *Bedri Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 prillit 2019).
54. Gjykata, fillimisht para së gjithash, vëren se parashtruesit e kërkesës theksojnë se u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për arsye se sipas tyre, marrëveshja për pranimin e fajësisë paraqet shkelje të rëndë për shkak të ricilësimit të veprës penale nga ana e prokurorit të rastit dhe ata nuk pajtohen me sanksionin penal të shqiptuar ndaj personit F. GJ.
55. Duke iu referuar pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht kujton nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, i cili përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.[...]”.

56. Gjykata thekson se vetë fjalja e nenit 6 të KEDNJ-së (“*në ngarkim të tij*”), e bën të qartë që në rastet penale ky nen garanton mbrojtjen e personit i cili përballlet me një kallëzim penal (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 24 tetorit 1986, paragrafi 65; dhe *Đekić dhe të tjerët kundër Serbisë*, nr. 32277/07, Aktgjykim i 29 prillit 2014, paragrafi 42).
57. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vëren se as Kushtetuta e as neni 6 i KEDNJ-së nuk akordon ndonjë të drejtë, në kuptimin e saktë të fjalës, për t’i ndjekur ose dënuar palët e treta përkitazi me një vepër penale. Prandaj, e drejta për ndjekje ose dënim të palëve të treta për kryerjen e një veprë penale nuk mund të ngrehet në mënyrë të mëvetësishme. Në mënyrë që e drejta në fjalë të hyjë në fushëveprimin e Kushtetutës ajo duhet të jetë e pandashme nga e drejta e parashtruesit për të paraqitur padi civile të bazuar në ligjin e zbatueshëm, madje edhe nëse bëhet fjalë për riparim simbolik ose të mbrojë një të drejtë civile siç është e drejta për “*reputacion të mirë*” (shih, rastin e GJEDNJ-së *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), nr. 12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 24, dhe po ashtu, *mutatis mutandis*, shih rastin e GJEDNJ-së *Perez kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 70-71 si dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese KI23/15, parashtrues *Miladin Anđelković*, cituar më lart, paragrafi 32; dhe rastin e Gjykatës KI52/18, parashtrues *Zoran Stanišić*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafi 50).
58. Gjykata rrjedhimisht, vëren se për sa i përket pretendimit të parë lidhur me ricilësimin e veprës penale dhe sanksionin ndaj personit F. GJ. në kuadër të procedurave penale, Gjykata fillimisht rithekson se mënyra se si zhvillohet apo ndërpritet procedura penale, dënohen të pandehurit apo zbulohen kryesit e veprave penale është diskrecion dhe prerogativë e gjykatave të rregullta dhe organeve të ndjekjes që atyre u është akorduar me ligj dhe me Kushtetutë, kështu që çdo ndërhyrje e Gjykatës në atë fushëveprim përbën cenim të autonomisë së tyre (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI23/15, parashtrues *Miladin Anđelković*, cituar më lart, paragrafi 36 dhe rastin nr. KI98/12, parashtrues *Ruzhdi Shala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 prillit 2013, paragrafi 41).
59. Për më tepër, Gjykata duke rikujtuar praktikën e GJEDNJ-së, thekson se kjo e fundit ka trajtuar çështjen e përshtatshmërisë së sanksioneve penale në disa sfera tjera kryesisht në sferat e nenit 3 dhe 8 të KEDNJ-së, dhe kryesisht për disa kategori të ndjeshme të parashtruesve dhe sa i përket detyrimit të parashikimit të disa veprave penale me legjislacionin vendor dhe sanksioneve penale përkatëse të cilat do të ndikonin në zbatimin e dispozitave të ligjit penal në mënyrë efektive (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *M dhe C kundër Bullgarisë*, nr. 39272/98, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2003, paragrafi 153; dhe rastin *X dhe Y kundër Holandës*, nr. 8978/80, Aktgjykim i 26 marsit 1985).
60. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës kanë ngritur pretendimet e tyre në kuadër të së drejtës së tyre kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, përshtatshmëria e sanksioneve penale nuk përfshihet në këtë të drejtë.

61. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesve të kërkesës sa i përket ricilësimit të veprës penale dhe sanksionit penal në raport me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së është i papranueshëm si *ratione materiae* i papajtueshëm me Kushtetutën siç përcaktohet me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.

(ii) Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në aspektin civil

62. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave së parashtruesve të kërkesës, Gjykata rithekson që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi 2 i nenit 47 të Ligjit dhe rregulli 39 (1) (b) i Rregullores së punës, ndër të tjera, qartë përcaktojnë detyrimin e *“shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj”*, me kusht që një kërkesë të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.
63. Gjykata rikujton pretendimin thelbësor të parashtruesve të kërkesës, përkatësisht çështjen e kompensimit, që sipas tyre është jokontestuese, dhe do duhej të ishte kompensuar nga i dënuari (personi F. GJ). Ata me këtë rast pohojnë se u është shkelur dhe *“parimi i qasjes në drejtësi”* sepse Gjykata e Apelit *“gabimisht ka hedhë poshtë ankesën si të palejuar”*, dhe se është shkelur dhe *“parimi i barazisë së armëve”* sepse personi F. GJ. ka përfituar vetëm benefitet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ndërsa obligimet e asaj marrëveshje, përkatësisht kërkesa për kompensim dëmi, nuk është shqiptuar.
64. Nisur nga kjo, Gjykata rikujton se në marrëveshjen për pranimin e fajësisë të 9 qershorit 2017 parashtruesit e kërkesës ishin ftuar të merrnin pjesë në këtë marrëveshje dhe kishin paraqitur dhe kërkesën e tyre pasurore-juridike, përkatësisht kërkesën për kompensim. Tutje, në procedurën pranë Gjykatës Themelore, kjo e fundit i kishte udhëzuar parashtruesit e kërkesës në kontest civil.
65. GJEDNJ përcakton se në rastet kur parashtruesit nuk parashtrojnë kërkesë të natyrës civile në kontekst të procedurës penale dhe kur dënimi penal nuk është parakusht zyrtar për marrjen e dëmshpërblimit në procedura civile, rezultati i procedurës penale nuk ka qenë vendimtar për *“të drejtat civile”* të parashtruesve, dhe në këtë mënyrë aspekti civil i nenit 6 të KEDNJ-së nuk u aplikua (shih rastin *Đekić dhe të tjerët kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 42). Megjithatë, për kontrast në rastin *Perez kundër Francës*, GJEDNJ, aplikoi nenin 6 të KEDNJ-së sa i përket aspektit civil sepse sipas legjislacionit francez, procedurat me të cilat dikush pretendon se është viktimë e një veprë penale janë vendimtare për *“të drejtat civile”* të tij që nga momenti kur ai është bashkuar si palë civile (shih *Perez kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 66).
66. Gjykata bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për kompensim dëmi të shkaktuar nga vepra penale, gjatë procedurave penale dhe ushtruan të drejtën e tyre për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar nga vepra penale për të cilën ata ishin palë e dëmtuar. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në mënyrë që e drejta në fjalë të hyjë në fushëveprimin e Kushtetutës ajo duhet të jetë e pandashme nga e

drejta e parashtruesit për të paraqitur padi civile të bazuar në ligjin e zbatueshëm, madje edhe nëse bëhet fjalë për riparim simbolik ose të mbrojë një të drejtë civile siç është e drejta për *“reputacion të mirë”* (shih, citimet më lart, në paragrafin 57).

67. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kjo çështje bie në kuadër të fushës së nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ-së dhe rrjedhimisht të nenit 31 të Kushtetutës.
68. Megjithatë, Gjykata rikujton rregullin 39 paragrafin (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton që *“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse: (b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”*.
69. Bazuar në sa më sipër, Gjykata rikujton që Aktgjykimi Pml. nr. 89/2018, i 8 majit 2018 i Gjykatës Supreme, Aktvendimi PAKR. nr. 397/17, i 19 gushtit 2017 i Gjykatës Apelit dhe Aktgjykimi PKR. nr. 61/14, i 21 qershorit 2017 i Gjykatës Themelore kanë udhëzuar parashtruesit e kërkesës që në kontekst civil të realizojnë kërkesën e tyre pronësore-juridike. Gjykata Supreme, më tej kishte arsyetuar që:
- “[...] gjykata e shkallës së parë ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në të cilën asnjëherë nuk është cekur se i dënuari duhet të kompensojë shumën e caktuar – kërkesën pronësoro-juridike të palës së dëmtuar, edhe pse avokati mbrojtës ka potencuar se nuk kundërshton kërkesën pronësoro-juridike, gjë që nuk do të thotë se është pajtuar ta kompensojë këtë kërkesë, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pronësore-juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil”*.
70. Gjykata rikujton se në nenin 463, paragrafi 1 të KPPRK-së theksohet se *“Për kërkesat pasurore-juridike vendos gjykata. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton që “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore-juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore-juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.
71. Bazuar në faktet e lartpërmendura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës në cilësinë e palës së dëmtuar, kanë parashtruar kërkesën për kompensimin e dëmit në setin e procedurave penale. Ata u udhëzuan nga gjykatat e rregullta që realizimin e kërkesës pasurore-juridike ta bëjnë në kontest civil. Mirëpo ata nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë për të vazhduar me procedurat ligjore në gjykatat kompetente.
72. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton dhe rastin e GJEDNJ-së, *Nikolov kundër Bullgarisë* ku parashtruesi i kërkesës z. Nikolov, ishte viktimë/i dëmtuar nga dy persona, të cilët kishin kryer një vepër penale kundër tij. Autoriteti përkatës prokurorial, dhe kryesit e veprave penale kishin lidhur një marrëveshje për

pranimin e fajësisë e cila ishte aprovuar nga gjykata e shkallës së parë. Parashtruesi në atë rast ishte ankuar pranë GJEDNJ-së se sanksioni penal ndaj kryesve të veprave penale ishte joproporcional dhe se gjykatat e rregullta nuk ishin të pavarura dhe të paanshme, sa i përket miratimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë të kryesve të veprave penale dhe si rezultat kërkesa e tij civile, përkatësisht kompensimi nuk ishte shqyrtuar. GJEDNJ i sqaroi parashtruesit të kërkesës se gjykatat në procedurë civile do të jenë në gjendje të merren me kërkesën e tij për kompensim, marrë parasysh dhe faktin që tashmë ekzistonte marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe si rrjedhojë ai kishte mjet alternativ të menjëhershëm, i cili nuk cenonte të drejtën e parashtruesit në gjykatë dhe nuk ishte joproporcional me kërkesat e nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Nikolov kundër Bullgarisë*, nr. 39672/03, Vendim i 28 shtatorit 2008).

73. Në anën tjetër, ngjashëm me rastin pranë nesh, lidhur me kërkesën pasurore-juridike të paraqitur në procedurë penale, Gjkata në rastin e saj KI52/18, kishte vendosur që Gjkata Themelore në atë rast ishte marrë me kërkesën për kompensim të parashtruesit të kërkesës, duke deklaruar se "*më qëllim të realizimit të kërkesës pronësore-juridike, udhëzohen në procedurë të rregullt civile*", dhe sipas Gjykatës parashtruesi i kërkesës në atë rast nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, sepse nuk ka specifikuar në kërkesë nëse, për të realizuar kërkesën e tij, ai ka ushtruar mjetet juridike që i kishte në dispozicion (shih në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI52/18, parashtrues *Zoran Stanišić*, cituar më lart, paragrafët 55-56).
74. Në ilustrimin e rasteve të mësipërme, Gjkata vëren se (i) GJEDNJ, kishte marrë parasysh faktin nëse parashtruesi i kërkesës kishte mjet alternativ tjetër dhe kishte konstatuar se një veprim i tillë nuk rezultonte në shkelje të kërkesave të nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, ndërsa (ii) Gjkata kishte vendosur që parashtruesi i kërkesës në rastin KI52/18, nuk kishte shterur mjetet juridike të parapara me ligj, duke iu referuar kështu kërkesës pasurore-juridike të parashtruar në procedurë penale. Në rastin pranë nesh, rezulton që parashtruesit e kërkesës kanë mundësi të ndjekin procedurat civile për kërkesën e tyre pasurore-juridike.
75. Rrjedhimisht, Gjkata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike që u janë dhënë atyre me ligjin e zbatueshëm (shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendim i 25 nëntorit 1996, rasti i Gjykatës KI07/09, *Demë dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 28-29).
76. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesit e kërkesës t'i kenë shteruar të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore para se të vijnë në Gjykatën Kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, Rasti i GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendim i 25 nëntorit 1996, shih rastet e Gjykatës KI120/11, *Ministria e Shëndetësisë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 dhjetorit 2012, paragrafi 32,

KI118/15, *Dragiša Stojković*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 majit 2016, paragrafi 34).

77. Arsyetimi i kërkesës për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe në nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese (shih rastin e GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës*, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 74 dhe, ndër të tjera, shih rastet e Gjykatës nr. KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST SHPK*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 16; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).
78. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe faktin që parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion në gjykatat e rregullta, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të vlerësojë nëse është shkelur edhe neni 46 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili rrjedh si pasojë e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës. Ndërsa sa i përket pretendimeve për shkeljen e neneve 21, 22, 53 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata i gjen këto pretendime të pabazuara, sepse parashtruesit e kërkesës vetëm kanë cituar këto nene të Kushtetutës dhe nuk kanë ofruar asnjë argument ose provë me të cilën do t'i kishin mbështetur dhe justifikuar këto shkelje të pretenduara.
79. Prandaj, duke marrë parasysh se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurat pranë gjykatave të rregullta para se të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk i përmbush kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

Përfundim

80. Në fund Gjykata, konstaton se:

- (i) Sa i përket pretendimit për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së lidhur me ricilësimin e veprës penale dhe sanksionin penal të shqiptuar ndaj personit të tretë, është *ratione materiae* i papajtueshëm me Kushtetutën; dhe

- (ii) Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së lidhur me kërkesën për kompensim dëmi, është i papranueshëm sepse parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar mjetet juridike.

Kërkesa për seancë dëgjimore

81. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore.
82. Gjykata rikujton rregullin 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] paragrafi 2 i Rregullores së punës, përcakton që *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit”*.
83. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110 - ku thuhet se *“Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në rast [...]”*).
84. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *“provave apo ligjit”* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti.
85. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesve të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (b) e (3) (b), dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 15 janar 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi